



Datë: 06/04/23 Ref.: 439/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 110-të, të mbajtur me datë 28.03.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, Nr.Prot.152/23 e datës 13.02.2023 për riakreditimin e programit të studimeve;
 1. *Menaxhment dhe marketing BSc, 180 ECTS;*
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universitetit Kadri Zeka në Gjilan, ka parashtruar kërkesë për riaplikim Nr.Prot.152/23 e datës 13.02.2023 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për riakreditim të programit të studimit;

1. *Menaxhment dhe marketing BSc, 180 ECTS;*

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim). Në paragrafin 1.2 të nenit 10 të UA, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-se".

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit".

Të dhënat janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 28 mars 2023, dhe pas shqyrtimit të detajuar të aplikacionit/kërkesës, verifikimit të dokumentacionit relevant të kualifikimit për secilin staf akademik të programit të studimit, KShC mori vendim që të refuzoj aplikacionin.

Sipas vendimit të KShC Nr.ref.146/23 të datës 09.02.2023 për programin e studimit: *Menaxhmenti dhe marketingu BSc, 180 ECTS*; *Universiteti Kadri Zeka në Gjilan si bartës të këtij programi, kishte paraparë: Art Shala, PhD në Marketing, Naim Mustafa, PhD në Shkencat Ekonomike, Nexhat Shkodra, PhD në Shkenca ekonomike në fushën e ekonomisë.*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit të Universiteti Kadri Zeka, duhet të ketë të paktën tre (3) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit për stafin akademik, KShC ka konstatuar se bartësi Art Shala, PhD në Marketing, në E-Akreditimi nuk ka të ngarkuar dokument që dëshmon thirrjen akademike. Naim Mustafa, PhD në Shkencat Ekonomike, në E-Akreditimi nuk ka të ngarkuar dokument që dëshmon thirrjen akademike/nuk hapet. Kurse Nexhat Shkodra, PhD në Shkenca ekonomike në fushën e ekonomisë, KShC ka konstatuar se i njëjti është bartës në një program që tashmë është akredituar.

*Andaj bazuar në faktet e prezantuara, dispozitat ligjore të sqaruara më lartë (Nenin 26, pika 5.3.4 dhe nenit 10, pika 1.1.4 të UA për Akreditim dhe Manualit të akreditimi (përditësuar me vendimin Ref.932/22), KShC në mungesë të stafit akademik adekuat të fushës së studimit, vendosi që të refuzoj aplikacionin për programin e studimit *Menaxhmenti dhe marketingu BSc, 180 ECTS*.*

KShC në mbledhjen e datës 28.03.2023 ka shqyrtuar riaplikimin e Universitetit Kadri Zeka në Gjilan Nr.Prot.152/23 e datës 13.02.2023 dhe pas verifikimit të të dhënave për programin ka konstatuar se: Programi *Menaxhment dhe marketing BSc, 180 ECTS*, ka ndryshime substanciale dhe nuk mund të trajtohet si riakreditim. Kështu që mbi këtë bazë KShC ka vendosur që të refuzoj riaplikimin e Universitetit Kadri Zeka në Gjilan për programin *Menaxhment dhe marketing BSc, 180 ECTS*.

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në organin kompetent në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit Kadri Zeka në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë